



# DOKUMENTA PER T'I PARAQITUR PËR REGJISTRIM GJATË VITIT SHKOLLOR

Prindërit janë të lutur të vijnë të shoqëruar me fëmijën e tyre dhe të paraqesin dokumentat e mëposhtëm\* :

## 1P- 8P: NXËNËSIT ME BANIM NË GJENEVË

➤ një dokument zyrtar në emër të fëmijës;

*(kartë identiteti, pasaportë, librezë/çertifikatë familjare, akt lindjeje, leje qëndrimi e bërë në Gjenevë ose kartë legjitimiteti e bërë në kantonin e Gjenevës)*

➤ një dokument zyrtar nga prindi që shoqëron fëmijën ditën e regjistrimit;

*(kartë identiteti, pasaportë, leje qëndrimi e bërë në Gjenevë ose kartë legjitimiteti e bërë në kantonin e Gjenevës)*

➤ një provë regjistrimi pranë shoqërisë së sigurimit shëndetësor (LAMal);

*(një vërtetim i shoqërisë së tij të sigurimit shëndetësor, ose karta e shëndetit e vlefshme)*

*Fëmijët e pajisur me kartë legjitimiteti mund të paraqesin një vërtetim regjistrimi pranë një shoqërie sigurimi shëndetësor të bërë nga zyra e punëdhënësit të prindërve.*

➤ kontrata e qerasë dhe fatura SIG jo më vonë se e 3 muajve të fundit;

➤ vërtetim banimi i lëshuar nga Zyra kantonale e popullësisë dhe e migracionit (OCPM) (ose karta e fundit e votimit) për fëmijën dhe të paktën për njërin nga prindërit ose përfaqësuesit ligjorë, që banojnë me fëmijët, jo më vonë se e 3 muajve të fundit (<https://www.ge.ch/obtenir-attestation-ocpm>);

*Fëmijët e pajisur me kartë legjitimiteti mund të paraqesin një vërtetim banimi në kantonin e Gjenevës për familjen e bërë në zyrën e punëdhënësit të prindërve të tij. Ky dokument zëvendëson gjithashtu kopjen e kontratës së qerasë ose të faturës SIG.*

\*dokumenta vërtetues plotësues mund të kërkohen.